



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR

Raport¹

mbi ecurinë e treguesve që monitoron Banka e Shqipërisë, në kuadër të procesit të deeuroizimit

Shkurt 2021

¹ Ky raport del në kuadër të përcaktimeve në Memorandumin e Bashkëpunimit mes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, “Për zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin financiar dhe në ekonominë shqiptare”, nënshkruar më 18.04.2017 dhe publikuar në adresën e internetit:

https://www.bankofalbania.org/web/pub/memorandumi_gksf_9384_1.pdf

Përmbajtja

I	Hyrje.....	3
II	Përmbledhje.....	3
III	Ecuria e treguesve	5
IV	Konkluzion.....	12
	Aneks I. <i>Paketa e masave të Bankës së Shqipërisë në drejtëm të deeuroizimit (Shkurt 2018)</i>	
	<i>dhe treguesit e monitorimit</i>	14
	Aneks II. <i>Veprime rregullative të mëparshme që ndikojnë në drejtëm të deeuroizimit</i>	16

I Hyrje

Në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, si dhe me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, nënshkruar në datën 18 prill 2017, Banka e Shqipërisë ndërmori një paketë masash konkrete për të stimuluar përdorimin e monedhës vendase. Paketa e masave, e cila u miratua me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në shkurt 2018, përbëhet nga tre elemente kryesore: i) diferencimi i rezervës së detyrueshme për detyrimet në valutë; ii) kërkesa më të larta për treguesit e likuiditetit në valutë; iii) ndërgjegjësimi i huamarrësve për rrezikun që paraqet kredia në valutë. Efikasiteti i masave monitorohet përmes disa treguesve dhe vlerësohet në bazë të ndryshimit në nivelin e euroizimit të sistemit financiar, para dhe pas implementimit të tyre. Më shumë detaje lidhur me masat dhe treguesit e përcaktuar për monitorimin e efektit të tyre, jepen në Aneksin 1.

Rezultatet e këtij vlerësimi, si dhe gjykimi mbi përshtatshmërinë e masave për arritjen e objektivit (nxitja e përdorimit më të madh të monedhës kombëtare në ekonomi) komunikohen çdo gjashtëmuor, përmes publikimit të këtij raporti.

Sikurse theksohet në Memorandum, synimi i Strategjisë nuk është arritja e nivelit zero të përdorimit të monedhave të huaja, pasi niveli i hapjes së ekonomisë sonë me vendet partnere tregtare nënkupton praninë e rëndësishme të monedhave të huaja në sistemin tonë financiar. Objektivi është pakësimi i përdorimit të monedhave të huaja deri në një nivel që konsiderohet i natyrshëm për një ekonomi të ngjashme me atë shqiptare.

II Përmbledhje²

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2020 (në vijim, “periudha”), pjesa më e madhe e treguesve që lidhen me veprimtarinë bankare, kanë njohur përmirësim krahasuar me fundin e gjashtëmuorit të kaluar, duke sinjalizuar një përdorim më të ulët të valutës. Depozitat në valutë dhe kredia në valutë në raport, përkatësisht, me totalin e depozitave dhe kredive, kanë shënuar rënie në nivelet më të ulëta historike. Nga ana tjetër, raportit “kredi në valutë të pambrojtura ndaj kursit të këmbimit ndaj totalit të kredive në valutë” është rritur lehtë. Raporti “aktive likuide në valutë ndaj pasiveve afatshkurtra në valutë” ka shënuar rritje, duke u luhatur në përgjigje të ecurisë së zerave të lartpërmendur të veprimtarisë bankare. Nëse vlerësohet vetëm ecuria e treguesve të sektorit bankar, duket sikur efekti i masave të zbatuara nga Banka e Shqipërisë është ndjerë gjatë vitit 2020. Nga ana tjetër, ky vit përmban zhvillime të veçanta e të forta mbi ekonominë dhe sjelljen e familjeve e të bizneseve, të lidhura me situatën e pandemisë dhe veprimet për përballimin e saj, të cilat nuk lejojnë të arrihet në një konkluzion të qartë mbi prirjen e treguesve dhe efektivitetin e masave.

² Treguesit e monitoruar në këtë raport paraqiten të zhveshur nga efekti tremujor i luhatjeve në kursin e këmbimit të monedhës kombëtare ndaj monedhave kryesore të huaja (euro dhe dollar amerikan). Për matjen e efektit të kursit në portofolin e kredive të secilës bankë është përdorur formula: $X_t0 - X_{t-1} - (X_{t0}/K_{t0} - X_{t-1}/K_{t-1}) * K_{t-1}$. Ku, X përfaqëson vlerën në monedhën vendase, K është kursi i këmbimit i shprehur në lekë për njësi të valutës, dhe t është periudha e shprehur në tremujorë.


Krahasuar me fundin e qershorit 2020, në dhjetor 2020 janë vënë re këto ndryshime:

Depozitat – depozitat në valutë ndaj totalit të depozitave të klientëve shënuan nivelin 50.9%, krahasuar me 52% që ishin në fund të qershorit 2020 dhe 51.7% një vit më parë, ndërsa depozitat mbi një vit në monedhën vendase vijuan rënien e lehtë, duke shënuar 14.2% të totalit të depozitave;

Likuiditeti – aktivet likuide në valutë ndaj pasiveve afatshkurtra në valutë për sistemin shënuan nivelin 32.9%, me një rritje prej 2.5 pikë përqindjeje (pp) krahasuar me fundin e qershorit 2020;

Kreditë – rreth 50.4% e portofolit të kredive është në valutë dhe kjo peshë është 2.3 pp më e ulët se ajo e fundit të qershorit 2020. Ndërkohë, kreditë e pambuluara ndaj rrezikut të kursit të këmbimit përbëjnë 42% të kredive në valutë, ose 0.7 pp më shumë se fundi i gjashtëmuorit të parë 2020. Rritja e këtij treguesi gjatë periudhës ka qenë e përqëndruar, duke sugjeruar që nuk jemi përballë një ndryshimi të prirjes afatgjatë rënëse të tij.

Grafik 1. Treguesit kryesorë për monitorimin e nivelit të përdorimit të valutës në sektorin bankar shqiptar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim: Për secilin tregues, niveli i rrezikut është përcaktuar duke iu referuar një pragu krahasues. Për treguesit “depozita në valutë ndaj totalit të depozitave” dhe “kredi në valutë ndaj totalit të tepriçës së kredisë”, pragu krahasues është niveli prej 30%, sipas gjykimit ekspert. Për vlera nën 30% të këtyre treguesve, niveli i rrezikut konsiderohet “i ulët” (ngjyra e gjelbër). Për treguesin “aktive likuide në valutë ndaj pasiveve afatshkurtra në valutë”, pragu krahasues llogaritet duke i shtuar një devijim standard të serisë kohore, kufirit rregullativ prej 20%. Për vlera më të ulëta se ky prag krahasues, treguesi sinjalizon “nivel të lartë” të rrezikut. Për treguesin e “depozitave me afat mbi një vit në lekë ndaj totalit të depozitave në lekë”, pragu krahasues është përcaktuar sipas gjykimit ekspert në nivelin 40%.

III Ecuria e treguesve³

Në këtë pjesë përshkruhet ecuria e treguesve të listuar në hyrje të materialit. Ecuria e treguesve, e zhveshur nga efektet e kursit të këmbimit, synon vlerësimin sa më realist të ndikimit të masave. Ashtu siç është paraqitur në vijim, lajmërimi i paketës së masave nuk ka pasur efekt të menjëhershëm mbi treguesit e analizuar.


Ecuria e Depozitave

Gjatë periudhës, pesha e depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave ka pësuar turrje, duke shënuar nivelin 50.9% në fund të dhjetorit 2020. Ky nivel është 1.1 pp më i ulët krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe 0.8 pp më i ulët krahasuar me një vit më parë. Ecuria e treguesit të peshës ka vijuar të luhetet në vlera të qëndrueshme përgjatë 2020, duke shënuar vlerën më të ulët në tremujorin e parë dhe të katërt të vitit.

Rënia e nivelit të treguesit është ndikuar nga rritja e totalit të depozitave (emëruesi) me 2.5 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe 8.2 pp krahasuar me një vit më parë. Sipas bankave, vlera më e lartë e rritjes së totalit të depozitave, në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, ishte 7.6 pp.

Rritje kanë pësuar edhe depozitat në valutë (numëruesi), me 0.4 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe 6.4 pp krahasuar me një vit më parë. Sipas bankave, vlera më e lartë e rritjes së depozitave në valutë, në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, ishte 4.1 pp.

Grafik 2. Raporti “depozita në valutë / totali i depozitave”, për sektorin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Për periudhën, treguesi i peshës reflekton një shpërndarje relativisht të ngushtë, duke u luhatur në nivelet 41.5% deri 60.2%. Aktualisht rezulton se 7 nga 12 banka që operojnë

³ Në këtë analizë janë rishikuar vlerat e T3 dhe T4 2018 për të reflektuar ndryshimet strukturore në sektorin bankar. Efekti i tyre ka qenë minimal dhe nuk ka pasur ndikim në konkluzionet e analizës.

në sistemin bankar shënojnë nivelin mbi 50% për këtë tregues, duke i bërë ato subjekt të normës më të lartë të rezervës së detyrueshme (20%) për pjesën e depozitave në valutë që kapërcen raportin 50% të totalit të depozitave. Për pasojë, këto banka duhet të përballen me kosto financiare për mbajtjen e valutës në nivelet mbi 50%. Në kushtet e normave shumë të ulëta të interesit për investimin e valutës, këto kosto për bankat janë më të ulëta se në një rast të kundërt.

Gjatë periudhës, treguesi i peshës ka rënë për pjesën më të madhe të bankave, duke shënuar një vlerë më të ulët se mesatarja e sektorit. Në tërësi, shpërndarja e vlerave të treguesit për bankat jepet në Grafikon 3.


Grafik 3. Shpërndarja e vlerave të treguesit “depozita në valutë/ totali i depozitave”, për bankat e sektorit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në vijim, pesha e depozitave në lek me afat maturimi mbi një vit ndaj totalit të depozitave ka ruajtur prirjen rënëse. Treguesi shënoi nivelin prej 14.2% në fund të dhjetorit 2020, duke u tkurrur gjatë periudhës me 0.6 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me 1.1 pp krahasuar me një vit më parë.

Grafik 4. Raporti “depozita mbi një vit në lekë/ totali i depozitave”, për sektorin bankar




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në rënien e këtij raporti, gjatë periudhës, ndikimin përcaktues negativ e ka dhënë rritja e totalit të depozitave (emëruesi), ndërsa ecuria e depozitave në lek me afat mbi një vit (numëruesi) ka dhënë kontribut pozitiv, duke u rritur me 3.2 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me 9.5 pp krahasuar me një vit më parë. Sipas bankave, vlera më e lartë e rritjes së depozitave në lek me afat mbi një vit, në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, ishte 9.9 pp.

Shpërndarja e treguesit të mësipërm konsiderohet e gjerë dhe reflektohet në vlerat e minimumit dhe maksimumit, të cilat variojnë nga 0.36% në 38.1%. Sipas bankave, 5 prej tyre e kanë vlerën e raportit më të lartë se vlera mesatare e sektorit.

Grafik 5. Shpërndarja e vlerave të raportit “depozita në lek me afat maturimi mbi një vit/ totali i depozitave”, për bankat e sektorit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ecuria e Aktiveve Likuide në valutë

Ecuria e aktiveve likuide, gjatë periudhës, tregon se sektori bankar vijon të karakterizohet nga nivele të kënaqshme likuiditeti, si në lek ashtu edhe në valutë. Duke iu referuar treguesit “aktive likuide në valutë ndaj detyrimeve afatshkurtra në valutë” në nivel sektori, konstatohet se ai shënoi nivelin prej 32.9% në fund të periudhës, duke u rritur me 2.5 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe duke shënuar një rënie prej 5.8 pp krahasuar me një vit më parë.

Për periudhën, rritja e treguesit të sektorit është ndikuar nga rritja e konsiderueshme e aktiveve likuide në valutë prej 8.6 pp. Sipas bankave, vlera më e lartë e rritjes së aktiveve likuide në valutë në krahasim me gjashtëmujorin e mëparshëm rezultoi 26 pp, me ndikimin kryesor nga dollari amerikan.


Grafik 6. Raporti “aktive likuide në valutë/ detyrime afatshkurtra në valutë”, për sektorin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shpërndarja e vlerave të treguesit për valutën sipas bankave të sektorit (Grafiku 7) tregon se të gjitha bankat paraqiten mbi nivelin e kërkuar rregullator dhe vlera mesatare e treguesit është rritur. Gjithashtu, rritje ka shënuar edhe vlera maksimale e treguesit, duke u ngjitur në rreth 50%.

Grafik 7. Shpërndarja e vlerave të raportit “aktive likuide në valutë/ detyrime afatshkurtra në valutë”, për bankat e sektorit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ecuria e Kredisë në valutë

Sektori bankar ka vijuar të zgjerojë portofolin e kredisë, pavarësisht efekteve negative të shkaktuara prej pandemisë Covid-19. Megjithatë, kur zhvishet nga efekti i kursit të këmbimit, rezulton që teprica e kredisë në valutë është tkurrur gjatë periudhës me rreth 11.6 miliardë lekë, duke bërë që pesha e saj të bjerë me 2.3 pp, në nivelin 50.4%.


Grafik 8. Raporti “kredi në valutë/ totali i kredive”, për sektorin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në grafikun 9 paraqitet shpërndarja e treguesit sipas bankave përgjatë dy viteve të fundit. Gjatë periudhës, pesha e kredisë në valutë ka pësuar rënie në shumicën e bankave të sektorit, gjë që reflektohet në një vlerë më të ulët të mesatares dhe të medianës së treguesit. Po ashtu, rënie kanë shënuar edhe vlerat minimale e maksimale të treguesit, duke shënuar përkatësisht nivelet 34.6% dhe 77.2%. Megjithatë, për shumicën e bankave, kjo peshë vijon të jetë mbi nivelin mesatar të sektorit, duke i treguar ato më të ekspozuara ndaj luhatjeve të pafavorshme të kursit të këmbimit.

Grafik 9. Shpërndarja e vlerave të raportit “kredi në valutë/ totali i kredive”, për bankat e sektorit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ndër kreditë në valutë, kreditë më të ekspozuara ndaj rrezikut të kursit të këmbimit janë ato ku të ardhurat e subjektit huamarrës janë në monedhë të ndryshme nga monedha e përfitimit të kredisë (kreditë e pambrojtura në valutë). Në fund të vitit 2020, këto kredi përbëjnë 42.0% të kredive në valutë, ku peshën më të madhe të portofolit e zenë kreditë e pambrojtura në monedhën euro (me 90.0%), ndjekur nga kreditë e pambrojtura në dollar amerikan (me 9.9%).

Gjatë vitit 2020, teprica e kredisë së pambrojtur në valutë është tkurrur me 2.9%, si rezultat i rënies së ndjeshme të kredisë së pambrojtur në dollar amerikan me 23.5% dhe

qëndrueshmërisë së kredisë së pambrojtur në euro (është rritur me 0.2%). Rritja e peshës së kredive të pambrojtura në valutë me 0.7 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, është ndikuar nga një rënie më e lartë e emëruesit në krahasim me numëruesin.


Grafik 10. Raporti “kredi në valutë të pambrojtura për rrezikun e kursit të këmbimit/totali i kredive në valutë”, për sektorin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Megjithëse në nivel sektori vlera mesatare e treguesit është rritur gjatë periudhës, sipas bankave konstatohet se treguesi ka ardhur në përmirësim (rënie) për shumicën e tyre. Vlera maksimale është ulur dhe shumica e bankave kanë një vlerë të treguesit nën mesataren e sektorit. Shpërndarja e treguesit të kredive të pambrojtura ndaj rrezikut të kursit të këmbimit për bankat e sektorit paraqitet në grafikun 11, ku vërehet një zgjerim i shpërndarjes në tremujorin e fundit, i ndikuar kryesisht nga bankat më të mëdha.

Grafik 11. Shpërndarja e vlerave të raportit “kredi në valutë të pambrojtura ndaj rrezikut të kursit të këmbimit/totali i kredive në valutë”, për bankat e sektorit



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Ecuria e Borxhit Publik

Nga ecuria e borxhit publik deri në fund të shtatorit 2020⁴, vërehet:

- 1) rritje e peshës së letrave me vlerë të borxhit (titujve) me maturitet më të gjatë se 12 muaj;
- 2) rritje e peshës së detyrimeve në valutë të Qeverisë Shqiptare;
- 3) rritje e borxhit të brendshëm në masën 3.8% krahasuar me fundin e marsit 2020.

Përgjatë vitit 2020, është rritur huamarrja e qeverisë, në vjim të nevojës së diktuar dhe akute për përballimin e pasojave të tërmetit të nëntorit 2019 dhe të efekteve të pandemisë në vazhdim. Gjatë periudhës, financimi i borxhit të qeverisë në valutë është rritur me ritme më të shpejta se ai në lek, dhe si rezultat është ulur pesha e borxhit publik në monedhën vendase në nivelin 49.7%. Sipas monedhave, borxhi i brendshëm është i denominuar kryesisht në lek, ndërsa borxhi i jashtëm është në valuta të ndryshme, por kryesisht në euro.

Grafik 12. Ecuria e borxhit publik në lek dhe valutë (boshti majtas), si dhe pesha e borxhit publik në lek ndaj totalit (boshti djathtas)



Burimi: Të dhënat janë marrë nga faqja e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga Banka e Shqipërisë.

Pavarësisht se huamarrja në valutë, edhe nga jorezidentët, mund të sjellë efekte pozitive në drejtimet e diversifikimit të portofolit, rritjes së disiplinës së imponuar nga tregu dhe uljes së kostos mesatare të financimit të borxhit, ajo i bën financat e qeverisë më të ndjeshme ndaj goditjeve të tregjeve dhe nevojave për valutë, si edhe ndaj lëvizjeve të pafavorshme të kursit të këmbimit. Njëkohësisht, rritja e detyrimeve në valutë mund të shoqërohet me rritjen e transaksioneve në valutë në ekonominë e vendit, duke mos


⁴ Të dhënat më të fundit të publikuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë deri në momentin e publikimit të këtij raporti, i referohen fundit të muajit shtator 2020.

mbështetur në këtë mënyrë përdorimin e monedhës kombëtare. Për këto arsye, është e nevojshme që në vendimmarrjen për financimin e borxhit publik në valutë të merren në konsideratë në mënyrë të përshtatshme të gjitha mundësitë dhe rreziqet, duke balancuar nevojat afatshkurtëra me implikimet më afatgjata në politikat ekonomike.

Ecuria e Kursit të Këmbimit

Një kurs i ekuilibruar i këmbimit ndihmon në krijimin e një ambienti makroekonomik të stabilizuar. Në afat të gjatë, qëndrueshmëria e kursit të këmbimit ndihmon në stabilitetin financiar të vendit dhe rritjen e përdorimit të lekut nga operatorët ekonomikë. Në afat më të shkurtër, luhatshmëria e kursit të këmbimit ndaj situatave të ndryshme të stresit financiar ofron një mekanizëm të rëndësishëm mbrojtës për kuadrin makroekonomik dhe bilancet e agjentëve ekonomikë.

Grafik 13. Ecuria e kursit të këmbimit të lekut ndaj dy valutave kryesore (mesatare mujore)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë periudhës, ecuria e kursit të këmbimit të lekut ka qenë e qëndrueshme. Faktorët e kërkeses dhe të ofertës në treg, kanë sjellë një mbiçmim të lehtë të lekut ndaj euros, ndërsa raporti i lekut ndaj dollarit amerikan ka reflektuar kryesisht ndryshimet e këmbimit euro/usd në tregjet ndërkombëtare.

IV Konkluzion

Gjatë periudhës, levizjet në treguesit e përzgjedhur për analizën e ndikimit të masave të deeuroizimit, kanë dhënë sinjale të përzjera dhe kanë reflektuar efektet në ekonomi të goditjeve të forta nga shkaqe madhore natyrore.

Nga njëra anë, ecuritë e treguesve të përzgjedhur të veprimtarisë së sektorit bankar, kur zhvishen nga efektet e kursit të këmbimit, sugjerojnë një përdorim më të ulët të valutës në këtë veprimtari. Lëvizja është më e dukshme në treguesin e kredive në valutë në raport me totalin e portofolit të kredisë dhe më pak në ecurinë e depozitave në valutë ndaj totalit

të depozitave. Kredia në valutë e pambrojtur ndaj kursit të këmbimit shënoi rritje gjatë periudhës, por kjo rritje është e përqëndruar dhe mund të mos ketë ndikim në prirjen më afatgjatë të treguesit. Ndërsa lëvizjet në aktivet likuide janë rrjedhojë e lëvizjeve në elementet e sipërpërmendura të bilancit. Nga ana tjetër, borxhi publik në tërësi dhe komponenti i tij në valutë kanë shënuar rritje, duke sjellë efekte të mundshme në krahun e kundërt në një afat më të gjatë. Arritja në një konkluzion përfundimtar ndërlikohet, në kushtet kur gjatë periudhës politikat ekonomike dhe bilancet e subjekteve, duke përfshirë edhe atë të sektorit bankar, janë ndikuar nga veprimet financiare dhe sjelljet e agjentëve ekonomikë të lidhura me efektet e tërmetit të fundit të vitit 2019 dhe të pandemisë aktuale. Ky ndikim i konsiderueshëm dhe ndoshta përcaktues për periudhën që analizohet, duhet të jetë gjithësesi i përkohshëm në një afat më të gjatë.

Si rezultat, është e vështirë të dallohet efekti i faktorëve të ndryshëm në lëvizjet e treguesve të përzgjedhur gjatë kësaj periudhe (masat apo politikat e tjera ekonomike të lidhura me efektet e tërmetit e të pandemisë), të vlerësohet nëse këto lëvizje do të përcaktojnë prirje për ecurinë më afatgjatë të tyre dhe të përcaktohet efektiviteti i masave. Monitorimi dhe vlerësimi i zhvillimeve ekonomike dhe financiare mbeten të nevojshëm në vijimësi.

Aneks I. Paketa e masave të Bankës së Shqipërisë në drejtim të deeuroizimit (Shkurt 2018) dhe treguesit e monitorimit

1. Për të rritur peshën e monedhës vendase dhe njëkohësisht zgjerimin e maturitetit në strukturën e detyrimeve të sistemit bankar, **Banka e Shqipërisë vendosi të diferencojë normën e rezervës së detyrueshme⁵**, për kategoritë e përfshira në bazën e rezervës së detyruar, si vijon:

- 7.5% (nga 10% që ishte më parë) për detyrimet në lek që kanë një afat maturimi jo më të gjatë se 12 muaj;
- 5% (nga 10% që ishte më parë) për detyrimet në lek që kanë një afat fillestar më të gjatë se 12 muaj deri në 2 vjet;
- 12.5% (nga 10% që ishte më parë) për detyrimet në valutë, kur këto zënë nën 50% të totalit;
- 20% (nga 10% që ishte më parë) për pjesën e detyrimeve në valutë mbi 50% të totalit.

Monitorimi i efekteve të masës (1) bëhet nëpërmjet treguesve në vijim:

- *raportit të depozitave në valutë, të zhveshur nga efektet e kursit të këmbimit ndaj totalit të depozitave;*
- *raportit të depozitave mbi një vit⁶ në lek, ndaj totalit të depozitave në lek;*
- *ecurisë së strukturës së borxhit publik.*

2. Për administrimin më të kujdesshëm të rrezikut të likuiditetit, **Banka e Shqipërisë vendosi të rrisë kërkesën minimale rregullative për aktivet likuide në valutë⁷**, në nivelin 20% të detyrimeve afatshkurtra. Për aktivet likuide në lek, raporti u ruajt në nivelin prej 15%.

Monitorimi i efekteve të masës (2) do të bëhet nëpërmjet treguesit në vijim:

- *raporti i aktiveve likuide në valutë ndaj detyrimeve afatshkurtra në valutë, të zhveshura nga efekti i kursit të këmbimit.*

⁵ Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 13, datë 7.2.2018, “Për miratimin e normës së rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat”.

⁶ Ky tregues u konvertua për të shfaqur ecurinë e peshës së depozitave në lek mbi një vit, si synim i drejtpërdrejtë i uljes së normës së rezervës së detyrueshme në lek.

⁷ Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 14, datë 7.2.2018, “Për një ndryshim në rregulloren për administrimin e rrezikut të likuiditetit”.

3. Për rritjen e **ndërgjegjësimit të huamarrësve në lidhje me rrezikun e kursit të këmbimit**, Banka e Shqipërisë u ka kërkuar bankave⁸ që:

- në rastet kur klienti aplikon për kredi në monedhë të ndryshme nga monedha në të cilën ka të ardhurat, bankat t'i propozojnë huamarrësit një kredi alternative në të njëjtën monedhë me të ardhurat e tij, si dhe ta pajisin atë me një shembull konkret se si ndryshon kësti i kredisë në rast nënçmimi të lekut dhe/ose rritjeje të normës së interesit (me vlera të përcaktuara);
- të përfshijnë në kontratat e reja të kredisë në valutë (apo ato që ristrukturohen rishtas), opsionin për përdorimin e mekanizmave që zbusin rrezikun e tregut për kredimarrësin, në rastin kur plotësohen kushtet e dakorduara nga banka dhe huamarrësi.

Monitorimi i efektit të masave (3) bëhet nëpërmjet treguesve në vijim:

- *kredia në valutë ndaj totalit të portofolit, i zhveshur nga efekti i kursit të këmbimit;*
- *kredia në valutë e pambrojtur nga kursi i këmbimit, ndaj totalit të kredive në valutë, i zhveshur nga efekti i kursit të këmbimit;*
- *rezultatet e vrojtimit të nivelit të përdorimit të euros në vendet e Evropës Qendrore e Juglindore (EQJL) që përgatitet një herë në vit nga Banka Qendrore e Austrisë (përfshihet vetëm në raportin e publikuar në stinën e verës).*

⁸ Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 15, datë 7.02.2018, "Për disa ndryshime në rregulloren mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare".

Aneks II. Veprime rregullative të mëparshme që ndikojnë në drejtim të deeuroizimit

Nr.	Masa	Data e adoptimit/e zbatimit	Përshkrim
1.	Kufizimi i huave në valutë të pambrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit	Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 62, datë 14.9.2011, “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, neni 15	Huatë në valutë, të dhëna për huamarrësit e pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit (pra, ku të ardhurat e huamarrësit janë në lek), nuk duhet të kapërcejnë nivelin 400% të vlerës së kapitalit rregullator të bankës. Çdo vlerë mbi këtë nivel, zbritet nga vlera e kapitalit rregullator.
2.	Kërkesa minimale për aktive likuide në valutë	Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës nr. 75, datë 26.10.2011, dhe nr. 28, datë 27.3.2013	Vendosja e një kërkesë minimale për vlerën e raportit të aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra, në nivelin 15%, e zbatueshme veçmas për lekun dhe për valutat kryesore (euro, dollar amerikan), dhe në total në nivelin 20%.
3.	Kërkesa më e lartë për kapital, lidhur me huatë në valutë të pambrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit	Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 48, datë 31.7.2013, “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”	Huatë në valutë ndaj huamarrësve të pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit, ponderohen me koeficient më të lartë rreziku (150%), për qëllime të llogaritjes së treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës.